



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni Pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 37
Prishtinë, më 12. 05. 2010, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Sabri Hamiti, Ramë Buja, Enis Kervan, Ibrahim Gashi dhe Slllobodan Petroviq.

Munguan: Xhavit Haliti, Ardian Gjini dhe Nexhat Daci.

Nga pjesëmarrësit e tjerë: Sanije Berisha – OSBE, Lumnije Murati – ZPRK, Albana Bylykbashi – MPJ dhe Besnik Ramadanaj – KDI.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Sabri Hamiti - kryetar i Komisionit.

R E N D I I D I T Ë S

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 2 prill 2010;
3. Shqyrtimi Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës;
4. Bashkëpunimi i Komisionit për Punë të Jashtme me komisionet homologe;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 2 prill 2010

Procesverbali i mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 2 prill 2010, u miratua njëzëri.

3. Shqyrtimi Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës

Sabri Hamiti – Lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës, tha se në cilësi të Komisionit funksional do ta shqyrtojmë dhe do të vendosim për miratimin ose për mosmiratimin në

parim. Ky Projektligj përmban 3 nene dhe ka për qëllim ndryshimin e procedurave rreth emërimit të ambasadorëve dhe të shefave të misioneve, përkatësisht propozon ndryshimin e nenit 6 dhe nenit 7 të Ligjit në fuqi.

Komisioni pas diskutimit dhe shqyrtimit të Projektligjit në parim e nxori këtë

P ë r f u n d i m

1. Përkrahet miratimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës;

2. Formohet grupi i punës në përbërje: Ibrahim Gashi, raportues, Enis Kervan dhe Slobodan Petrovic anëtarë, për shqyrtimin dhe amendamentimin e Projektligjit në procedurën e mëtutjeshme.

3. I rekomandohet Kuvendit që në mbledhjen plenare të radhës ta miratojë Projektligjin në parim.

4. Bashkëpunimi i Komisionit për Punë të Jashtme me komisionet homologe

Sabri Hamiti – Njoftoi se është duke u punuar për organizimin e konferencës me vendet e rajonit, që nga Komisioni është planifikuar të mbahet në gjysmën e dytë të shtatorit. Kemi pasur kontakte në Parlamentin e Bullgarisë dhe është përkrahur kjo nismë. Së shpejti për këtë qëllim, së bashku me z. Xh. Haliti, do ta vizitojmë edhe Kroacinë.

Nga komisionet homologe të Kuvendit të Shqipërisë dhe të Maqedonisë, në kuadër të bashkëpunimit, kemi marrë ftesa për vizita pune. Propozoj që këto vizita pune të realizohen gjatë majit dhe qershorit.

Komisioni pas diskutimit për ftesat për vizita zyrtare në Shqipëri dhe Maqedoni e nxori këtë

P ë r f u n d i m

Sipas ftesave të komisioneve homologe do të realizohen vizitat zyrtare në Republikën e Shqipërisë dhe të Maqedonisë gjatë majit dhe qershorit 2010.

Në Republikën e Shqipërisë, për vizitë zyrtare, do të udhëtojnë deputetët: Sabri Hamiti, Xhavit Haliti, Nexhat Daci, Ardian Gjini dhe Enis Kervan.

Në Republikën e Maqedonisë, për vizitë zyrtare, do të udhëtojnë deputetët: Sabri Hamiti, Xhavit Haliti, Ibrahim Gashi, Slobodan Petroviq dhe Ramë Buja.

5. Të ndryshme.

Sabri Hamiti - Në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet grupeve të miqësisë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, i njoftoi anëtarët e Komisionit se Grupi i Miqësisë së Asamblesë Nacionale të Francës, do ta vizitojë Kuvendin e Kosovës nga data 15 deri më 18 qershor 2010.

Mbledhja përfundoi në orën 10: 45.

Kryetari i Komisionit

Sabri Hamiti

E përgatiti:

Njësia për mbështetje të Komisionit